

UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDIM

Nr. 7, datë 29.03.2019

MBI

“MIRATIM PËR FITIMIN OSE JO TË BURSAVE TË SHKOLLIMIT PËR  
STUDENTËT E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2018-  
2019, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Mbështetur në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.903, datë 21.12.2016. “Përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” (i ndryshuar); Urdhrin nr.50, datë 03.12.2018 “Mbi përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studenët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë, në Universitetin e Arteve” (i ndryshuar), Bordi i Administrimit pasi diskutoi rreth **Relacionit**, paraqitur nga Administrator i UART znj. Alma Sinanaj dhe duke u bazuar ne aktet e dala për këtë qëllim, te shqyrtuara e te paraqitura nga Grupi i Punës dhe pasi e diskutoi,

V E N D O S I:

1. Miratimin për fitimin ose jo të bursave të shkollimit, të studentëve të Fakulteteve të Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2018-2019, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur vendimit.
2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakultetet e Universitetit të Arteve dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

